



Në mbështetje të Ligjit 03/L-100 për Ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme nr.03/L-204, nenit 12.2 (c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, si dhe nenit 27.1 pika 3 të Statutit të Komunës së Deçanit, Kuvendi Komunal i Deçanit në mbledhjen e vet të mbajtur me datë 27.09.2012, aprovoj këtë:

RREGULLORE MBI TATIMIN NË PRONË

Neni.1

Perkufizimet

1.1. Sipas kësaj Rregullorje:

a) "Pronë e paluajtshme" do të thotë Tokat dhe ndertesat, stabilimentet dhe godinat mbi dhe në sipërfaqen e tokës dhe të cilat janë të lidhura me token. Në pronën e paluajtshme përfshihen edhe njesit mbrenda ndertesave siq janë banesat dhe zonat për qëllime komerciale.

b) "Vlerë e tregut" do të thotë qmimi me të cilin blerësi është i gatshëm të blejë dhe shitësi të shesë pronën e paluajtshme në një transaksion zyrtar, ku as njëri nuk është në ndonji detyrim për të vepruar dhe nuk ekziston ndonji marrëdhënie përmes palëve përmes lidhjeve familjare, Martesës, pronësisë së përbashkët apo lidhjes biznesore.

c) "Pronar i pronës" do të thotë personi Juridik ose fizik i cili është titullar i pronësisë mbi pronën dhe i cili është i regjistruar si pronar në tokë në regjistrin e të drejtave mbi pronësinë e paluajtshme.

d) "Tatim pagues" do të thotë pronari i pronës që tatimohet.

e) "Faturë tatim", do të thotë dokument që i lëshohet tatimpaguesit nga Komuna me të cilin njoftohet tatimpaguesi për përgjigjësinë e periudhës së tatimit

f) "Periudhë tatimore" do të thotë viti kalendarik për të cilin tatimohet prona.

Neni.2.

Dispozitat e përgjithëshme

2.1. Me këtë Rregullore caktohet tatimi në prone, kriteret për caktimin e bazës tatimore, norma e tatimit, vlerësimi i pronës, shuma e detyrimit dhe ndarja e zonave.

2.2. Të hyrat e vjelura nga tatimi në prone do të derdhën në llogari të Komunës dhe të njejtat do të përdoren nga ajo në përputhje me Ligjin mbi menaxhimin financiar.

Neni 3.

3.1.Do të tatimohen:

a)Prona e domosdoshme për qëllime të banimit në të cilën përfshihen shtëpitë,banesat dhe ndertesat e ngjashme.

b)Prona Komerciale që do të thotë ajo prone e cila shfrytëzohet për qëllime biznesore.

c)Prona industriale e cila shfrytëzohet për produkte artikujsh,për prodhim,perpunim ose deponim të mallrave duke përfshirë fabrikat,depot ,punëtoritë dhe objektet e tjera të ngjashme.

d)Prona bujqësore që nenkupton tokat dhe banesat të cilat shfrytëzohen për qëllime bujqësore dhe

e)Prona e paluajtshme e braktisur dhe objektet të pabanuara.

3.2.Pronat rezidenciale vlerat e të cilave nuk e kalojnë shumën prej 10.000,00 €, lirohen nga tatimi në pronë.

Neni.4.

4.1.Duke u bazuar në Ligjin për tatimin në pronën e paluajtshme, baza tatimore do të caktohet si më poshtë:

Sipas Zonave në bazë të vlerës së tregut në m²

Zona	Lokal afarist	Apart-mantet	Shtëpi	Garazh	Objekte Industri.	Objekte Bujqso.	Objekte Të pa Përfun duara	Pishina noti dhe Terene sportive
I	700	400	400	200	300	200	160	70
II	600	350	350	150	250	150	140	60
III	500	300	300	100	200	100	120	50
IV	400	200	250	100	200	100	100	40

Neni 5.

5.1.Normat tatimore percaktohen sipas Udhëzimit Administrativ të MF 03/2011.

Neni 6.

6.1Duke u bazuar ne vendodhjen e pasurisë e cila ndikon dukshem ne vleren e saj në Komunen e Deçanit janë përcaktuar 4 zona te cilat paraqesin ndryshime të theksuara ne vleren e pasurisë.

Neni 7.

7.1. Zona e pare përfshinë:

- Sheshin “ Mentor Tolaj”
- Rugen “ Luan Haradinaj”
- Rugen “ Dëshmorët e Kombit”
- Rugen”Salih Çeku”
- Rugen e “ Manastirit” dhe
- Rugen “Haki Povataj” në qytetin e Deçanit

7.2. Zona e dytë përfshinë:

- Rugen “ Mehmet Uka”
- Rugen “ Brigada 131”
- Rugen “ Elena Gjika” dhe

7.3 Zona e tretë përfshinë :

-Të gjitha rrugët e qytetit të Deçanit të cilat nuk janë të përfshira në zonën e parë dhe të dytë si dhe fshatrat nëpër të cilat kalon rruga e asfaltuar, të cilat janë : Strellci I Epërm, Lëbusha, Isniqi ,Duboviku, Prapaqani, Llluka e Epërm, Llluka e Ulët, Lumbardhi ,Pozhari, Carrabregu i Epërm dhe i Ulët, Prejlepi,Rastavica, Lagjeja “ Dëshmoret e Kombit”, Prokolluki, Irzniqi, Glllogjani Dubrava, Belegu, Dranoci , Lloqani, Sllupi, Shapteji, Baballoqi , Hulaj, Pobergja, Strellci i Ulët, Vokshi, Kodralia dhe Gramaqeli.

7.4 Zona e katertë përfshinë:

-Të gjitha fshatrat e Komunës së Deçanit të cilat nuk janë të cekura në pikat 1,2,dhe3 te ketij neni, të cilat janë:Belleja, Dashinoci, Mazniku, Papiqi, Ratishi i Epërm, Ratishi i Ulët, dhe Vranoci i Vogël.

Neni 8.

8.1Në pajtim me Ligjin për tatimin në pronën e palujtëshme, normat tatimore te tatimit në prone për pronën e paluajtshme për vitin tatimor 2012 për Komunën e Deçanit janë siq vijon:

Nr	Lloji I pronës	Norma e indeksit 2012	Norma e indeksit 2013
1.	Prona Komeriale	0.25%	0.30%
2.	Prona industriale	0.2%	0.25%
3.	Prona rezedenciale /private/	0.1%	0.15%
4.	Prona bujqësore	0%	0.00%

Neni 9.

- a) Çdo pronar apo shfrytezues I patundshmerisë është I obliguar që të paguaj tatimin sipas shumës së përgjithshme të sipërfaqes së objektit .
- b) Të gjithë pronaret do të marrin obligimin mbi tatimin e pagimit në pronë të përcaktuar konform dispozitave të Rregullorës .
- c) Tatim paguesi ka të drejtë në ankesë në afatë prej 30 ditësh pasë marrjes së faturës së tatimit duke ju drejtuar Bordit të ankesave të tatimit në prone
- d) Vendimi I Bordit të ankesave është definitive në procedurën administrative .
- e) Pala e pa kenaqur mund të inicojë procedurën e kontestit Administrativ.
- f) Ankesa nuk e ndalon ekzekutimin e obligimit tatimor.
- g) Bordin e ankesave e emronë Kryetari.

Neni 10.

- 10.1. Për vitin tatimor 2011 afati I pagesës së shumës së faturuar është 60 ditë pas marrjes së faturës së tatimit.
- 10.2. Për vitin tatimor 2012 dhe vitet vijuese tatimi I caktuar sipas Rregullorës duhet të paguhet në dy kiste të barabarta, me se largu deri më 30 qeshor dhe me se largu deri me 31 dhjetor të vitit tatimor ose edhe përpara.
- 10.3. Në raste të mos pagesesë së faturës sipas afateve obliguesi tatimor do të paguaj se bashku së bashku me shumën e tatimit edhe kamaten ndeshkuese sipas përqindjes së interesit në Bankat Komerciale për shkak të vonesës së konstatuar , në të kundërtën do të bëhet nderprerja e të gjitha shërbimeve Komunale për obliguesin tatimor dhe anëtarët e familjes së tij
- 10.4. Nëse nuk përmbushen obligimet e cekura në këtë nen atëherë do të pasoj inkasimi I dhunshëm I bazuar në ligj.

Neni 11.

11.1. Pronat të cilatë lirohen nga tatimi në prone e të cilat janë të cekura në Ligjin për Tatimin në pronën e palujtëshme, lirohen nga tatimi edhe në Komunën e Deçanit.

Neni 12.

12.1 Shtyerja e pagimit të tatimit në kushte të veqanta mund të bëhet konform Ligjit për Tatimin në pronën e palujtëshme Nr.03/L-204 .

Neni 13.

13.1. Ligji mbi tatimin në pronën e palujtëshme në Kosovë rregullon të gjitha qeshtjet tjera të cilatë kanë të bëjnë me tatimin në prone e të cilatë nuk janë përfshirë në këtë Rregullore Komunale.

Neni 14.

14.1.Implementimin e kesaj Rregullorje do ta bëjë Drejtoria për Buxhet dhe financa-Zyra e Tatimit në Pronë, pranë Kuvendit Komunal të Deçanit.

Neni 15.

15.1.Kjo Rregullore aprovohet nga ana e Kuvendit Komunal me datë 27.09.2012, dhe e njëjta do të zbatohet duke filluar me dt.01.01.2013.

01.Nr.X-8
Deçan, dt.27.09.2012

Kryesuesi i Kuvendit
Jashar Dobraj
